

R E L A C I O N
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E FORMATIT TIP TË MARRËVESHJES QË LIDHET NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT DHE INVESTITORIT PËR TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektakti është miratimi i formatit tip të marrëveshjes që lidhet mes AKB dhe investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektakt është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe nuk është i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja për hartimin e këtij projektvendimi vjen si rezultat i domosdoshmërisë së rregullimit të mënyrës së operimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit nga subjektet/përdoruesit që gëzojnë statusin “Investitor Strategjik”, sipas parashikimeve të ligjit nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Projektvendimi përcakton formën dhe mënyrën e lejit të përdorimit të brigjeve të detit, liqeneve, lumenjve dhe shtretërve të tyre, si dhe zonave përkatëse, në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik, për subjektet që gëzojnë një status të tillë dhe ofrojnë shërbimin e stacionit të plazhit.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve”

Sipas marrëveshjes tip saktësohet territorin/sipërfaqen për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke identifikuar nëpërmjet koordinatave fikse këtë zonë, si dhe standardet/kriteret që duhet të ofrohen nga përdoruesi i plazhit. Disiplinon ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit nga subjektet/ përdoruesit që gëzojnë statusin “Investitor Strategjik”, për të gjithë zonën bregujore, si rezultat i nënshkrimit të kontratave tip me secilin prej tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim bazohet në nenin 100 të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 29 të ligjit 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis-communitaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim përbëhet nga 2 pika, si vijon:

1. Miratimin e formatit të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit në fushën e turizmit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektakt është hartuar nga strukturat e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Projektvendimi është dërguar për mendim tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet sistemit e-aktet, në datën 26.1.2026 është shprehur si vijon:

Ministria e Drejtësisë shprehet parimisht dakord, brenda fushës së saj të përgjegjësisë duke sugjeruar si më poshtë vijon:

1. Referuar shkronjës “a”, të nenit 9, Kreu III, të Udhëzimit nr.6/2022, të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, sugjerojmë unifikimin e titullit të projektvendimit, sipas autorizimit ligjor të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar.

2. Në kuadër të unifikimit të bazës ligjore të projektvendimit me bazën ligjore të relacionit shoqërues, rekomandojmë që ligji nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, vendimi nr. 649, datë 16.10.2024, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar dhe vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike, të hiqen nga përmbajtja e kreut IV, të relacionit, në kushtet kur nuk autorizojnë miratimin e këtij projektvendimi.

3. Sa i përket modelit tip të marrëveshjes bashkëlidhur projektvendimit, Ministria e Drejtësisë nuk mund të shprehet për shkak të karakterit teknik të tij, por sugjeron të mbahet në vëmendje që në përmbajtje të marrëveshjes tip të parashikohet një dispozitë lidhur me hyrjen në fuqi të saj, e cila duhet të qartësojë momentin se kur kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe ka vlefshmëri ligjore. Kjo lejon përdoruesin që përpara vënies në funksion të strukturës akomoduese, të nisë procedurat për pajisjen me leje ndërtimi për infrastrukturën mbështetëse të stacionit të plazhit dhe njëkohësisht bëhet dallimi midis hyrjes në fuqi të marrëveshjes, si akt juridik dhe fillimit të efekteve të përdorimit të brigjeve, i cili mbetet i kushtëzuar deri në

përfundimin e investimit kryesor, në përputhje me pikën 5, të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në vijim të këtij argumenti, sugjerojmë që togfjalëshi “kjo marrëveshje”, të hiqet nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 3, të marrëveshjes dhe të shtohet një nen i ri lidhur me hyrjen në fuqi të saj.

Pas shqyrtimit, shprehemi si vijon:

Në lidhje me pikën 1, sqarojmë se:

Titulli i projekt vendimit: “*Për Miratimin e Formatit tip të Marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi*”, është në përputhje me pikën 1, 2, 5 të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet:

Neni 29

E drejta e përdorimit të brigjeve

1. Lejimi i përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi, në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik në fushën e turizmit miratohet me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike pas marrjes së mendimit paraprak nga institucionet, kompetencat e të cilave shtrihen në këto zona.

2. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, përcakton afatin kohor të lejimit të përdorimit, i cili nuk mund të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) vjet, si dhe koordinatat përkatëse. Marrëveshja përkatëse lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit, në mbështetje të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike dhe sipas koordinatave të përcaktuara në të. Modeli i marrëveshjes tip miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Në çdo rast, gëzimi i përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve dhe lumenjve si stacione plazhi fillon efektet pas vënies në funksion të strukturës akomoduese turistike.

Në lidhje me pikën 2, bëjmë me dije se ky koment është pranuar dhe reflektuar në tekstin e relacionit.

Në lidhje me pikën 3, sqarojmë se është riformuluar neni 3 dhe është shtuar një nen i ri lidhur me hyrjen në fuqi, përkatësisht:

Neni 3

Kohëzgjatja

1.Kjo marrëveshje lidhet me një afat kohor, (_____) vjetësh, sipas Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike, në zbatim të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 10

Hyrja në fuqi

1.Kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe prodhon efekte juridike nga momenti i vënies në funksion të strukturës akomoduese turistike.

2. E drejta e përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve dhe lumenjve si stacione plazhi ushtrohet vetëm pas hyrje në fuqi të kësaj marrëveshje.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale nëpërmjet sistemit e-aktet, në datën 3.2.2026 është shprehur si vijon:

1. Pas pikës 2, të projektvendimit të shtohet një pikë 3, me këtë përmbajtje:
“3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe struktura përgjegjëse e varësisë, për monitorimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit publik në stacionet e plazhit”.

2. Në nenin 5, “Të drejtat dhe detyrimet e dhënësit” të marrëveshjes, të shtohet një pikë 6, me këtë përmbajtje:

“6. Dhënësi në bashkëpunim me strukturat e shëndetit publik dhe Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, siguron që hapësira e dhënë në përdorim të jetë objekt i kontroleve periodike sanitare dhe epidemiologjike, sipas legjislacionit në fuqi”.

3. Në nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit”, pika 4, pas shkronjës “h”, të shtohen shkronjat “i”, “j”, “k”, “l” dhe “m”, me këtë përmbajtje:

“i) të sigurojë pikën e ndihmës së shpejtë funksionale, si edhe prani të personelit të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë;

j) të përmbushë dhe të respektojë kushtet dhe kërkesat për furnizimin me ujë të pijshëm të sigurt, që përmbush plotësisht standardet e cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor;

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve”

k) të kryejë instalimet e nevojshme për shkarkimin e ujërave të ndotura në sistemin e kanalizimeve, si dhe të respektojë kushtet për ndërtimin, implementimin, zgjerimin, rehabilitimin dhe/ose mirëmbajtjen e këtij sistemi;

l) të respektojë kushtet dhe kërkesat për menaxhimin e mbetjeve inerte, si dhe të mbetjeve urbane të krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit;

m) të sigurojë pastrimin dhe mirëmbajtjen e bregut, në përputhje me standardet mjedisore në fuqi, përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

4. Në nenin 7, pika 1, “Penalitetet”, pas shkronjës g), të shtohet një shkronjë gj) me këtë përmbajtje:

“gj) Shkeljet e standardeve të shëndetit publik ndëshkohen edhe sipas legjislacionit shëndetësor në fuqi, përfshirë Ligjin nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij, pavarësisht penaliteteteve të kësaj marrëveshjeje”.

Pas shqyrtimit, shprehem si vijon:

Detyrimet e subjekteve që mund të lidhin një kontratë plazhi, pavarësisht se në këtë rast i referohen subjekteve që disponojnë statusin “investitorë strategjik”, janë të përcaktuara në Rregulloren e plazheve, konkretisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar, ndaj nuk janë të nevojshme të ri-përcaktohen në marrëveshjen që lidhet me këta subjekte.

Konkretisht në draft marrëveshjen tip, Rregullorja e Plazheve, është përcaktuar në pjesën e “Bazës ligjore”, si më poshtë vijon:

Bazuar në:

Ligji nr. 55/2025, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Vendimin Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar,

Rregullorja e plazheve në nenet 8, 9, 10, 11, përcakton në mënyrë të detajuar kriteret që duhet të plotësojë një stacion plazhi dhe në të njëjtën formë nuk cënon veprimtarinë e asnjë institucioni tjetër inspektues, përfshirë dhe strukturat e shëndetësisë.

Sqarojmë gjithashtu se marrëveshja me investitorin strategjik, i referohet vetëm pjesës ranore që subjekti do të kontraktojë dhe nuk prek të gjitha detyrimet ligjore

që subjekti ka sipas parashikimeve mbi ligjin për investitorin strategjik, mbrojtjen e mjedisit apo kuadrin ligjor në fuqi.

Ministria e Financave nëpërmjet sistemit e-aktet, në datën 3.2.2026 është shprehur si vijon:

Lidhur me parashikimin e pikës 1, të nenit 4, të marrëveshjes tip, ku përcaktohet se: "... Pagesa vjetore e tarifës për përdorimin e brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi, për të gjithë periudhën gjatë së cilës brigjet vihen në dispozicion të Përdoruesit, është fikse, e pandryshueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së afatit të marrëveshjes dhe do të jetë e barabartë me tarifën e përcaktuar nga Këshilli Bashkiak i Përfituesit për vënien në dispozicion të brigjeve, e cila është në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje...", vlerësojmë se në zbatim të pikës 3, të nenit 29 të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në marrëveshjen tip duhet të parashikohet e drejta e Këshillit Bashkiak për rishikimin periodik të tarifave, duke reflektuar minimalisht ndryshimet e indeksit të çmimeve ose normat e inflacionit.

Pika 2 e nenit 4, të riformulohet si vijon:

"Brenda muajit Tetor të çdo viti, Përfituesi i dërgon Përdoruesit faturën për arkëtim sipas formatit të miratuar me udhëzimin respektiv të Ministrit të Financave në të cilën shënohet vlera e tarifës që duhet të paguajë përdoruesi sipas parashikimeve të paragrafit 1 më sipër, llogaria ekonomike e tarifës, kodi i institucionit përfitues si dhe llogaria bankare e të ardhurave të thesarit në bankën e nivelit të dytë ku kjo tarifë do të arkëtohet. Përdoruesi bën pagesën e tarifës, brenda 30 ditëve nga marrja e faturës për arkëtim".

Në lidhje me nenin 4 të marrëveshjes tip "Të drejtat e përfituesit", vlerësohet e domosdoshme përfshirja e dispozitave që parashikojnë aplikimin e penaliteteve dhe masën përkatëse të penaltetit në rast vonese në shlyerjen e tarifës nga ana e Përdoruesit. Mungesa e këtyre mekanizmave përbën shkak për mospërmbyllje financiare, cënon sigurinë juridike të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe rrezikon keqpërdorimin e pronës publike.

Duke qenë se organet e vetqeverisjes vendore janë përfitues të kësaj marrëveshjeje, sugjerojmë që në pikën 5 të parashikohet e drejta e këtyre organeve për të raportuar dhe adresuar çdo problematikë që vjen nga shfrytëzimi i hapësirës së stacioneve të plazhit, si dhe të kërkojë brenda një kohe të caktuar zgjidhjen e këtyre problematikave me shpenzimet e përdoruesit.

Me qëllim minimizimin e ekspozimit të financave vendore, si në mënyrë direkte ashtu edhe indirekte, vlerësojmë se kjo marrëveshje duhet të jetë e më e detajuar, gjithëpërfshirëse dhe e aplikueshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Në këtë kuadër, është e nevojshme që marrëveshja të përfshijë mekanizma të qartë monitorimi, kontrolli dhe ndërhyrjeje, të cilët synojnë garantimin e zbatimit korrekt të detyrimeve kontraktore, mos ekspozimin e financave vendore dhe krijimin e një marrëveshje të balancuar në mbrojtje të interesave ekonomiko-financiare të bashkive, konkretisht:

- Përcaktimin e periodicitetit të kontrolleve të monitorimit ndaj subjekteve përfituese në periode, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kushteve të marrëveshjes nga ana e përdoruesit. Për çdo shkelje të konstatuar të marrëveshjes të aplikohen penalitete me natyrë financiare;
- Në lidhje me parashikimin e gërmës “c”, pika 2 e nenit 8 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve”, dhe nenit 9 “Njoftimi për zgjidhjen e marrëveshjes”, ku parashikohet zgjidhja e marrëveshjes vetëm pas një vendimi të formës së prerë të gjykatës administrative për mospërmbushje të detyrimeve nga përdoruesi, vlerësojmë se ky përcaktim duhet të rishikohet për të balancuar marrëveshjen, pasi ky përcaktim krijon një sërë efektsh juridike negative për Dhënësin dhe Përfituesin (palën shtetërore), të cilat lidhen kryesisht me kufizimin e kompetencave të tij në mbrojtjen dhe mirëadministrimin e pronës publike, mos përfitimin e tarifës, rritje të kostove procedurale dhe administrative për Dhënësin, si dhe shtyrjen e pasojave juridike. Në marrëveshje, duhet të parashikohen raste të zgjidhjes automatike në raste të shkeljes dhe moszbatimit të dispozitave thelbësore të saj, siç është pagesa e tarifës nga ana e përdoruesit, pa qenë e nevojshme pritja e një vendimi gjyqësor, çka do të shmangte vonesat dhe humbjet potenciale financiare;
- Parashikimin e dispozitave për rastet e ndryshimit të marrëveshjes nga secila prej palëve, duke përfshirë këtu ndryshimin e kontratës pa penalitete me natyrë financiare dhe me mirëkuptim për rastet e zbatimit të projekteve publike nga ana e organeve të vetqeverisjes vendore;
- Gjithashtu, në mënyrë që të ruhet pozita më e favorshme e palës publike, konsiderohet e domosdoshme që marrëveshja të parashikojë raste të tjera të zgjidhjes së saj, krahas penalitetiteve, përfshirë, por pa u kufizuar në: mos zhvillimi i investimit nga Përdoruesi, mungesa e personelit përgjegjës për sigurinë e plazhit, cenimin e sigurisë së jetës së qytetarëve, apo ndotja e rëndë të mjedisit. Në këto raste, autoriteti përgjegjës (AKB), vet apo me kërkesë të Përfituesit, duhet të ketë të drejtën të ndërmarrë masa administrative të menjëhershme, përfshirë pezullimin e aktivitetit dhe vendosjen e një afati korrigjues prej 5–10 ditësh. Në rast të moskorrigjimit brenda afatit të përcaktuar, të parashikohet zgjidhja e menjëhershme e marrëveshjes.

Për sa më sipër, kërkojmë rishikim tërësor të marrëveshjes, duke pasqyruar elementët e sipërcituar dhe duke respektuar parimin e balancës kontraktore, parimin e propocionalitetit dhe mbi të gjitha parimin efikasitetit të administrimit të pronës publike.

Sugjerojmë që në nenin 7 të modelit të projekt marrëveshjes të shtohet një pikë ku të përcaktohet se: “Të ardhurat e mbledhura nga gjobat derdhen 100% në buxhetin e shtetit”, parashikim ky i parashikuar edhe nga ligji 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar. Duke qenë se marrësi/përdoruesi është investitori, dhënësi është AKB ndërsa përfituesi është bashkia, ky projektvendim në zbatim të nenit 12, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, duhet të konsultohet dhe të marrë dakordësinë e njërive të vetëqeverisjes vendore që disponojnë brigje detare, liqenore apo lumore dhe preken nga marrëveshjet që mund të lidhen.

Për këtë arsye, vlerësojmë se projektakti duhet të paraqitet për mendim pranë Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit Konsultativ.

Pas shqyrtimit, shprehemi si vijon:

1. Lidhur me pikën 1, të nenit 4, të marrëveshjes tip, ku përcaktohet se: *vlerësojmë se në zbatim të pikës 3, të nenit 29 të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në marrëveshjen tip duhet të parashikohet e drejta e Këshillit Bashkiak për rishikimin periodik të tarifave, duke reflektuar minimalisht ndryshimet e indeksit të çmimeve ose normat e inflacionit*”, është riformuluar pika 1, të nenit 4:

1. *Duke filluar nga data e vënies në funksion të strukturës akomoduese, Përfituesi gëzon të drejtën e përfitimit të pagesës vjetore për përdorimin e brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi, objekt i kësaj marrëveshje. Paguesa vjetore e tarifës për përdorimin e brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi, për të gjithë periudhën gjatë së cilës brigjet vihen në dispozicion të Përdoruesit, është e barabartë me tarifën e përcaktuar nga Këshilli Bashkiak i Përfituesit për vënien në dispozicion të brigjeve, e cila është në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe mund të pësojë ndryshime sipas rishikimit periodik të tarifave nga ky Këshill.*

2. Në lidhje me pikën 2, të MF, ku përcaktohet se:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve”

Pika 2 e nenit 4, të riformulohet si vijon: “Brenda muajit Tetor të çdo viti, Përfituesi i dërgon Përdoruesit faturën për arkëtim sipas formatit të miratuar me udhëzimin respektiv të Ministrit të Financave në të cilën shënohet vlera e tarifës që duhet të paguajë përdoruesi sipas parashikimeve të paragrafit 1 më sipër, llogaria ekonomike e tarifës, kodi i institucionit përfitues si dhe llogaria bankare e të ardhurave të thesarit në bankën e nivelit të dytë ku kjo tarifë do të arkëtohet. Përdoruesi bën pagesën e tarifës, brenda 30 ditëve nga marrja e faturës për arkëtim”.., është bërë riformulimi i pikës 2, të nenit 4 si vijon:

*2. Brenda muajit Tetor të çdo viti, **Përfituesi i dërgon Përdoruesit faturën për arkëtim sipas formatit të miratuar me udhëzimin respektiv të Ministrit të Financave në të cilën shënohet vlera e tarifës që duhet të paguajë përdoruesi sipas parashikimeve të paragrafit 1 më sipër, llogaria ekonomike e tarifës, kodi i institucionit përfitues si dhe llogaria bankare e të ardhurave të thesarit në bankën e nivelit të dytë ku kjo tarifë do të arkëtohet. Përdoruesi bën pagesën e tarifës, brenda 30 ditëve nga marrja e faturës për arkëtim**”.*

3. Në lidhje me sugjerimin referuar nenit 4 të marrëveshjes tip “Të drejtat e përfituesit”, vlerësohet e domosdoshme përfshirja e dispozitave që parashikojnë aplikimin e penaliteteve dhe masën përkatëse të penaltetit në rast vonese në shlyerjen e tarifës nga ana e Përdoruesit. Mungesa e këtyre mekanizmave përbën shkak për mospërmbushje financiare, cënon sigurinë juridike të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe rrezikon keqpërdorimin e pronës publike., sqarojmë se:

Penalitetet janë parashikuar në nenin 7 të draft marrëveshjes, ndërsa mos-shlyerja e pagesës për sipërfaqen e kontraktuar është kusht për zgjidhjen e marrëveshjes, parashikuar në nenin 9 të draftit, nen i cili mund të riformulohet, në përmbushje të sugjerimit të MF, duke theksuar zgjidhjen e marrëveshjes në rast mos pagese të tarifës, menjëherë pas njoftimit paraprak, si më poshtë vijon:

1. Dhënësi, nëse Përdoruesi është në shkelje të detyrimit të tij sipas nenit 4, paragrafi 2 i marrëveshjes, me anë të një njoftimi me shkrim, informon Përdoruesin për detyrimin e tij për të korrigjuar mos përmbushjen e konstatuar brenda një afati jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

2. Në rast se, pas përfundimit të afatit të përcaktuar më sipër, konstatohet se Përdoruesi nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për përmbushjen

e detyrimit të tij për të paguar tarifën, Dhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë marrëveshje me përdoruesin, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje nga ana e Përdoruesit.

4. Në lidhje me sugjerimin e MF, ku përcaktohet se: Duke qenë se organet e vetqeverisjes vendore janë përfitues të kësaj marrëveshjeje, sugjerojmë që në pikën 5 të parashikohet e drejta e këtyre organeve për të raportuar dhe adresuar çdo problematikë që vjen nga shfrytëzimi i hapësirës së stacioneve të plazhit, si dhe të kërkojë brenda një kohe të caktuar zgjidhjen e këtyre problematikave me shpenzimet e përdoruesit, vlerësojmë se:

Mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit në terren janë të mirëpërcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë fushën e turizmit, mjedisit, ndërtimit dhe mund të realizohen sipas nevojave të inspektimit/kontrollit në çdo moment apo sipas planeve të monitorimit në terren, nga secili institucion kompetent, me qëllim mbikqyrjen e veprimtarisë dhe garantimin e ligjshmërinë në ushtrimin e veprimtarisë., ndaj nuk kanë pse të kufizohen në “periodike”.

5. Në lidhje me sugjerimet e MF, mbi pjesën e penaliteteve, kriteret në plazhe, si dhe diskutimin me NJVV-të, sqarojmë se:

Detyrimet e subjekteve që mund të lidhin një kontratë plazhi, pavarësisht se në këtë rast i referohen subjekteve që disponojnë statusin “investitorë strategjik”, janë të përcaktuara në Rregulloren e plazheve Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar, ndaj nuk janë të nevojshme të ri-përcaktohen në marrëveshjen që lidhet me këta subjekte.

Konkretisht në draft marrëveshjen tip, Rregulloreja e Plazheve është përcaktuar në pjesën e “Bazës ligjore”, si më poshtë vijon:

Bazuar në:

Ligji nr. 55/2025, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Vendimin Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar,

Ndaj kriteret dhe standardet e detyrueshme për zbatim nga ssubjektet për stacion plazhi, nuk kufizohen në këtë marrëveshje, por detajohen në Rregulloren e plazheve.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve”

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

MINISTRI

BLENDI GONXHJA

MINISTRI

DELINA IBRAHIMAJ